



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:064721
Datë: 04.10.2024
Numri i dokumentit: 06252537

Kom.Dh.Shk.II.nr.1550/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “IPKO Telecommunications” L.L.C, me numër të biznesit 70064420 dhe seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Z.B., kundër debitorit Komuna e Mitrovicës me seli në Mitrovicë, rr. “Bedri Gjinaj”, p.n., me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.756/23 të datës 04.07.2024, me datë 03.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e kreditorit “IPKO Telecommunications” L.L.C, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.756/23 të datës 04.07.2024, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.756/23 të datës 04.07.2024, në dispozitiv të aktvendimit ka aprovuar prapësimin e debitorit Komuna e Mitrovicës me seli në Mitrovicë, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 816/19, i lejuar me datë 27.11.2019, nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori me pretendimin se kreditori ka siguruar nga ana e Përmbauesit Privat dokumentet të cilat dëshmojnë se ky i fundit i ka dërguar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Ka shtuar se me rastin e kalimit të lëndës nën kompetencën e Gjykatës Komerciale mund të ketë pasur ndonjë lëshim në përcjelljen e dokumenteve. Me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.756/23 të datës 04.07.2024, apo ndryshohet apo lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë duke theksuar se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i ligjshëm dhe nuk përmban asnjërin nga shkeljet e dispozitave të LPP-së andaj ka kërkuar nga Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë –Departamenti për Çështje Ekonomike të refuzoj në tërësi të pabazuar ankesën e kreditorit ndërsa të vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.756/23 të datës 04.07.2024.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “IPKO Telecommunications” L.L.C, mbi bazën e dokumentit – fatura nr. 0729807; fatura nr. 0764798; fatura nr. 0788028; fatura nr. 0851387; fatura nr. 0893988; fatura nr. 0916982; fatura nr. 0951633; fatura nr. 1010054; fatura nr. 1121852; fatura nr. 1157820; fatura nr. 1205394; fatura nr. 3677752; fatura nr. 3831797; fatura nr. 3949907; fatura nr. 4043620; fatura nr. 0220171; fatura nr. 12197; fatura nr. 0284013; fatura nr. 0561502; fatura nr. 1158956; fatura nr. 1196046; fatura nr. 3277607; fatura nr. 3677756; fatura nr. 3831801; fatura nr. 3949911; fatura nr. 4043624; fatura nr. 0588717; fatura nr. 0616802; fatura nr. 1017513; fatura nr. 1044386; fatura nr. 1075152; fatura nr. 1121857; fatura nr. 3677757; fatura nr. 3831802; fatura nr. 3949912; fatura nr. 4043625; fatura nr. 0557388; fatura nr. 0558718; fatura nr. 0616803; fatura nr. 1017514; fatura nr. 107514; fatura nr. 1075153; fatura nr. 1196048; fatura nr. 232677; fatura nr. 3677758; fatura nr. 3831803; fatura nr. 3949913; fatura nr. 312633; fatura nr. 4043626; fatura nr. 0557389; fatura nr. 0588719; fatura nr. 64147; fatura nr. 0616804; fatura nr. 66110; fatura

nr. 0647444; fatura nr. 0674460; fatura nr. 0701371; fatura nr. 0729814; fatura nr. 0764805; fatura nr. 0787012; fatura nr. 0825543; fatura nr. 0862086; fatura nr. 0884730; fatura nr. 0923444; fatura nr. 0949118; fatura nr. 0978245; fatura nr. 1017515; fatura nr. 1044388; fatura nr. 1158959; fatura nr. 1196049; fatura nr. 3677759; fatura nr. 3831804; fatura nr. 3949914; fatura nr. 4043627; fatura nr. 12187; fatura nr. 0342119; fatura nr. 0528759; fatura nr. 0557390; fatura nr. 088720; fatura nr. 0616805; fatura nr. 0764806; fatura nr. 0978246; fatura nr. 1158960; fatura nr. 1196050; fatura nr. 3677760; fatura nr. 3831805; fatura nr. 3949915; fatura nr. 4043628; fatura nr. 1205395; fatura nr. 3277604; fatura nr. 3677753; fatura nr. 3831798; fatura nr. 3949908; fatura nr. 4043621; fatura nr. 0526454; fatura nr. 0557391; fatura nr. 0588721; fatura nr. 0618066; fatura nr. 0647446; fatura nr. 0674462; fatura nr. 68619; fatura nr. 0701373; fatura nr. 0729816; fatura nr. 0764807; fatura nr. 0791603; fatura nr. 104781; fatura nr. 0949120; fatura nr. 0978247; fatura nr. 1017517; fatura nr. 1039786; fatura nr. fatura nr. 1075156; fatura nr. 1112133; fatura nr. 1158961; fatura nr. 3677761; fatura nr. 3677761; fatura nr. 3831806; fatura nr. 3949916; fatura nr. 4043629; fatura nr. 0825546; fatura nr. 104726; fatura nr. 1039787; fatura nr. 1075157; fatura nr. 1158962; fatura nr. 1199311; fatura nr. 3677762; fatura nr. 3831807; fatura nr. 3949917; fatura nr. 4043630; fatura nr. 02472171; fatura nr. 0298994; fatura nr. 0313038; fatura nr. 0557393; fatura nr. 60316; fatura nr. 63499; fatura nr. 65462; fatura nr. 0911086; fatura nr. 208670; fatura nr. 256916; fatura nr. 3677763; fatura nr. 3831808; fatura nr. 3949918; fatura nr. 4043631; fatura nr. 0194396; fatura nr. 0198563; fatura nr. 0202839; fatura nr. 0207114; fatura nr. 0241278; fatura nr. 12195; fatura nr. 1005753; fatura nr. 1163735; fatura nr. 1199313; fatura nr. 3677764; fatura nr. 3831809; fatura nr. 3949919; fatura nr. 4061792; fatura nr. 0786581; fatura nr. 0917995; fatura nr. 0942104; fatura nr. 0978251; fatura nr. 1043196; fatura nr. 1086829; fatura nr. 1112137; fatura nr. 1163736; fatura nr. 1199314; fatura nr. 3684993; fatura nr. 3831810; fatura nr. 3949920; fatura nr. 4061793; fatura nr. 0674455; fatura nr. 0701366; fatura nr. 0729809; fatura nr. 0764800; fatura nr. 0788027; fatura nr. 0826522; fatura nr. 0851389; fatura nr. 0884725; fatura nr. 1010056; fatura nr. 1045557; fatura nr. 37677754; fatura nr. 3831799; fatura nr. 3949909; fatura nr. 4043622; fatura nr. 0351765; fatura nr. 0361870; fatura nr. 0382541; fatura nr. 0393424; fatura nr. 0528754; fatura nr. 0561501; fatura nr. 0674456; fatura nr. 0701367; fatura nr. 0729810; fatura nr. 0764801; fatura nr. 0788028; fatura nr. 1157823; fatura nr. 1196045; fatura nr. 1238312; fatura nr. 3677755; fatura nr. 3831800; fatura nr. 3949910; fatura nr. 4043623; fatura nr. 0557396; fatura nr. 0588726; fatura nr. 0618071; fatura nr. 0647451; fatura nr. 0672145; fatura nr. 0701378; fatura

nr. 0737938; fatura nr. 0760163; fatura nr. 79442; faturanr. 0789375; fatura nr. 0917996; fatura nr. 0978252; fatura nr. 1005755; fatura nr. 1043197; fatura nr. 1112138; fatura nr. 3592238; fatura nr. 3684994; fatura nr. 3831811; fatura nr. 4061794; fatura nr. 3949921; fatura nr. 0588727; fatura nr. 0618072; fatura nr. 0647452; fatura nr. 0672146; fatura nr. 0701379; fatura nr. 0737939; fatura nr. 0760164; fatura nr. 0789376; fatura nr. 1043198; fatura nr. 1086831; fatura nr. 1122664; fatura nr. 1163738; fatura nr. 1199316; fatura nr. 3684995; fatura nr. 3831812; fatura nr. 3949922; fatura nr. 4061795; fatura nr. 3255721; fatura nr. 3684996; fatura nr. 3831813; fatura nr. 3949923; fatura nr. 4061796; fatura nr. 0361881; fatura nr. 0384487; fatura nr. 0395282; fatura nr. 0526463; fatura nr. 0557399; fatura nr. 0672148; fatura nr. 0701381; fatura nr. 0737941; fatura nr. 0760166; fatura nr. 0790181; fatura nr. 1005758; fatura nr. 1163740; fatura nr. 1199318; fatura nr. 3684997; fatura nr. 3831814; fatura nr. 3949924; fatura nr. 4061797 dhe fatura nr. 0489949, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 816/19, të datës 27.11.2019, me të cilin është urdhëruar debitori Komuna e Mitrovicës, që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit në emër të borxhit shumë prej EUR 26,070.12, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e skadimit të pagesës për secilën faturë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim përmes së cilit e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetim se faturat objekt përmbarimi nuk përpunuar asnjëherë së bashku nga ana e palëve, mirëpo që kreditori çdoherë e ka lënë në faj debitorit për debitë. Ndërsa, ka shtuar se prapësimi debitori e bazon edhe tek mungesa e informatave nga vetë debitori lidhur me debitë sepse ka fatura të cilat janë paguar mirëpo që ende figurojnë si borxhi e duke pasur parasysh se debitori kërkon pagesën e borxhit për faturat të viteve prej 2014 deri 2019. Në fund, ka theksuar se urdhri përmbarimor nuk i plotëson kriteret ligjore dhe i njëjti është në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se të njëjtat janë të pa bazuara dhe nuk përmbushën asnjë nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet prapësimi dhe nuk ka bashkangjitur asnjë provë me të cilën do ta kontestonte borxhin ndaj kreditorit. Ka shtuar se debitori është faturuar në bazë të shërbimeve të shfrytëzuara në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar mes palëve, ku përcaktohet se debitori sot ë ketë në shfrytëzim numra prepaid (me parapagim) si dhe numra postpaid të cilët faturohen

në bazë të shpenzimeve mujore. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.756/23 të datës 04.07.2024, ku në dispozitiv të aktvendimit ka aprovuar prapësimin e debitoit Komuna e Mitrovicës me seli në Mitrovicë, ashtu që Urdhri Përmbarrimor P.nr. 816/19, i lejuar me datë 27.11.2019, nga Përmbarruesi Privat Rezarta Metaj, është shfuqizuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka gjetur se dokumentet, përkatësisht faturat e përshkruara si në hyrje të arsyetimit të këtij aktvendimi, mbi bazën e së cilave është paraqitur propozimi për përmbarrim dhe është lejuar urdhri, nuk i janë bashkangjitur fare propozimit për përmbarrim.

Gjykata Komerciale - Dhoma e shkalles se Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka shfuqizuar urdhrin përmbarrimor P.nr. 816/19, i lejuar me datë 27.11.2019, pasi që me rastin e vendosjes e faturat e përshkruara si në hyrje të arsyetimit të këtij aktvendimi, mbi bazën e së cilave është paraqitur propozimi për përmbarrim dhe është lejuar urdhri, nuk i janë bashkangjitur fare propozimit për përmbarrim.

Mirëpo, Gjykata e Shkallës së Dytë ka shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit dhe provat e bashkangjitura ku i njëjti pretendon se faturat janë dorëzuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, mirëpo që të njëjtat mund të mos kenë pas mundësi të përcillen në Gjykatën Komerciale për shkak të e kalimit të lëndës në Gjykatën Komerciale, dhe për të cilat kreditori ka bashkangjitur edhe akt përcjellëse bashkë me faturat. Andaj, me qellim te harmonizimit te shkresave ne lëndë, gjykata e shkallës së parë tani, pasi faturat janë bashkangjitur si provë duhet të vlerësoj nëse faturat i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform dispozitave ligjore të LPP-së. Gjykata e Shkallës së Dytë vlerëson se për shkak të konstatimit real te detyrimeve te debitorit marrë për bazë edhe pretendimet e palëve ne procedure, aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Shkallës së Dytë në rastin konkret aplikoi nenin 180 par të LPK-së në të cilin parashihet se “ Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja,

përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t'i paraqesë, përkatësisht t'i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë”.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se në këtë rast nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të aprovuar prapësimin e debitorit prandaj, ankesën e kreditorit e pranoi si të themeltë dhe çështjen vendosi t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike të vlerësojë dokumentin përbarimor, se a i plotëson kushtet nga neni 29 par.3 të LPP-së, e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1550/24 me datën 03.10.2024

Gj y q t a r i,
Faton Bajrami